REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 19644/2 prot.

Tiranë, më 16.11.2022

Lënda: Dërgohet Udhëzimi Shtesë i Udhëzimit Plotësues "*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022*".

**MINISTRIA/ INSTITUCIONI ______________**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT**

**DEGA E THESARIT____________________** ✓

Mbështetur në ligjin nr.115/2021 "*Për Buxhetin e vitit 2022*" dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit*", të ndryshuar, bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin nr.1/1, datë 6.11.2022, "Për një shtesë në Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022".

Duke vlerësuar bashkëpunimin.

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË – TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

13644/1 UDHËZIM PLOTËSUES 16.11.22.

Nr. 11 datë 16.11.2022

**"PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR.1, DATË 10.01.2022 'PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022"**

Në mbështetje të pikës 4. të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936. datë 26.06.2008. "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. nenit 21. të ligjit 115/2021, "Për Buxhetin e vitit 2022" dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", paragrafi 2,

**U D H Ë Z O J :**

Në Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022", në kreun I. "Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit", bëhet shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 93, shtohet germa "x" me përmbajtjen si më poshtë:

   "x. Të ardhurat për shërbimet ndaj të tretëve, të arkëtuara nga Agjencia për Efiçensën e Energjisë, të cilat do të përdoren për financimin e projekteve për instalimin e paneleve diellore, për ngrohjen e ujit sanitar për klientët familjarë, në zbatim të nenit 7. të Aktit Normativ nr. 14. datë 5.10.2022 "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike."

2. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2022.

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË